



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 pika d, dhe nenit 41 paragrafët 41.1 dhe 41.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, neni 30 të Statutit të Komunës së Dragashit, në Seancën e I-rë (inaguruese) të Kuvendit të Komunës së Dragashit me dt. 22.12.2025 pas votimit paraprak, miratohet ky:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT

I

z. Resul Fetahu (Delegat në Kuvendin e Komunës në Dragash) Zgjidhet në postin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Dragashit, që njëherësh, sipas nenit 52 të LVL-së dhe nenit 40.4 të Statutit të Komunës së Dragashit, është edhe Kryesues i Komitetit për Politikë e Financa i K.K-së Dragash.

II

Mandati i Kryesuesit zgjat katër vite, respektivisht deri në inaugurimin e Kuvendit të ardhshëm, përkatësisht deri sa mos të vendoset ndryshe nga Kuvendi i Komunës.

III

Punët dhe detyrat e kryesuesit të Kuvendit janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Statutin e Komunës së Dragashit si dhe i takojnë të gjitha të drejtat ligjore, duke përfshirë edhe nënshkrimin dhe vulosjen e akteve zyrtare të Kuvendit të Komunës së Dragashit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Dragash-it, z. Bexhet Xheladini,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
- Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-28138-1/25

Dt. 22.12.2025

Kryesuesi i Kuvendit (anëtari më i vjetër i Kuvendit) :



Usmen Baldži